

08/04/2022

Zyra e Rinisë së Kryepiskopatës organizon takime shpirtërore



Përgjatë këtyre ditëve të bekuara të Kreshmës së Madhe, Zyra e Rinisë së Kryepiskopatës organizon takime shpirtërore çdo të Enjte ora 18:00 te Salla e Rinisë pranë katedrales “Ngjallja e Krishtit” në Tiranë me tema të ndryshme që kanë lidhje me periudhën që po jetojnë të krishterët Orthodhoksë.

Tema e sotme u mbajt nga kleriku i Kishës sonë Atë Harallamb Gjoka – Eukaristia Hyjnore, Kungimi i Shenjtë.

Në takimin e radhës datë 14 Prill kemi të ftuar drejtorin e Shkollës së Muzikës Bizantine “Shën Joan Kukuzeli” z. Theodor Peci i cili do të na flasë për Himnologjinë e Javës së Madhe. Të pranishëm do të jenë edhe psaltët e korit të Katedrales që së bashku me drejtuesin e korit të artit psaltik do të performojnë edhe himne!

Ju ftojmë të merrni pjesë!

E Enjte datë 14 Prill 2022 ora 18:00







[Rinia Ortodokse Tirane](#)